

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të nenit 135 si dhe nenit 137, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2024, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PERIUdhËN KALIMTARE PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 08/L-328 PËR SHËRBIMET E PAGESAVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë periudhën kalimtare të zbatueshme për subjektet dhe personat që i nënshtrohen Ligjit Nr. 08/L-328 për shërbimet e pagesave-(Ligji për shërbimin e pagesave) për të përshtatur aktivitetet dhe operacionet e tyre me dispozitat e ligjit pas hyrjes së tij në fuqi, në kuadër të procesit të iniciuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës-(BQK) për të aplikuar në Këshillin Evropian të Pagesave për zgjerimin e fushëveprimit gjeografik të Zonës së Vetme të Pagesave në Euro në Kosovë dhe rrjedhimisht mundësinë që ofruesit kombëtarë të shërbimeve të pagesave t'i bashkohen “Skemave SEPA”, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar, autorizuar ose regjistruar për të ofruar shërbime pagesash në Kosovë në pajtim me Ligjin për shërbimet e pagesave.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për shërbimet e pagesave dhe në Rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për informatat që shoqërojnë transferet e fondeve dhe për përcaktimin e kërkesave për transferet e kredive dhe debitimet direkte në euro.
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë kuptimin e mëposhtëm:
  - 2.1. **Bankë** – nënkupton një bankë siç përcaktohet në Ligjin Nr. 08/L-304 për bankat;
  - 2.2. **EPC** – nënkupton Këshillin Evropian të Pagesave;
  - 2.3. **SEPA** – nënkupton Zonën e Vetme të Pagesave në Euro;
  - 2.4. **Transferta SEPA** – nënkupton transaksionet e pagesave të kryera në skemat SEPA, tërësisht ose pjesërisht, dhe që do të jenë, sipas rregullave të këtyre skemave dhe/ose siç përcaktohet nga EPC-ja, subjekt i rregullave përkatëse të skemave të SEPA;

- 2.5. **Skema SEPA** – nënkupton çdo skemë pagese të operuar nga EPC-ja.
- 2.6. **Ligji për bankat** – nënkupton Ligjin nr 08/L-304 për bankat, dhe/ose ligjin në fuqi për bankat;

### **Neni 3**

#### **Periudha kalimtare për ofruesit e shërbimeve të pagesave**

1. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave, duke përfshirë bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, të licencuar, autorizuar ose regjistruar nga BQK-ja që synojnë të marrin pjesë në një ose më shumë skema SEPA dhe/ose të ofrojnë transferta SEPA për klientët ose përdoruesit e tyre, duhet të përshtatin plotësisht aktivitetet dhe operacionet në përputhje me dispozitat e pjesëve III dhe IV të Ligjit 08/L-328 për shërbimet e pagesave, të paktën [një muaj] përpara aplikimit në EPC për pjesëmarrje në një skemë SEPA ose përpara ofrimit ose ekzekutimit të transfertave të kredisë SEPA për klientët ose përdoruesit e tyre.
2. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të përmendur në paragrafin paraparak do të njoftojnë BQK-në paraprakisht për çdo aplikim, ftesë dhe/ose negociim për t'iu bashkuar ose marrë pjesë në një skemë SEPA.
3. BQK-ja përcakton periudhën tranzitore lidhur me zbatimin e rregullores përkatëse të aplikueshme për ofruesin e shërbimit të pagesave.

### **Neni 4**

#### **Kërkesa të tjera**

Periudha kalimtare dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore nuk cenojnë pajtueshmërinë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave me çdo kërkesë, rregull, udhëzim ose kusht të zbatueshëm të EPC ose skemave SEPA për pjesëmarrje në skemat përkatëse SEPA dhe në përputhje me rregullat në fuqi të skemës.

### **Neni 5**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje i nënshtrohet masave ndëshkuese, të përcaktuara në nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 dhe nenin 124 të Ligjit Nr. 08/L-328 për shërbimet e pagesave.

### **Neni 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 10-(dhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-328 për shërbime të pagesave.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës